



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Kabineti i Ministrit

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

Minister's Cabinet

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabinet Ministra

POLITIKA E MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË PËR

ZHVILLIMIN E KURRIKULAVE NË ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË

I. Hyrje

Zbatimi i Procesit të Bolonjës në Kosovë ka filluar në vitin akademik 2001 / 2002 kur kishte orvatje për reformimin e kurrikulave të Universitetit të Prishtinës, asokohe institucioni i vetëm i arsimit të lartë në Kosovë. Kjo u bë në rrethana të një dualizmi të funksioneve në udhëheqje kur administratori ndërkombëtar i UP-së njëkohësisht kryente edhe funksionin e bashkëdrejtuesit të departamentit të arsimit. Ky proces ishte organizuar me një qasje lart-poshtë pa përfshirje të mësimeve në pjesën e analizës së gjendjes, hulumtimit të nevojave dhe planifikimit të procesit, por vetëm duke zbatuar hartimin e kurrikulave sipas objektivave të Bolonjës. Atëherë nuk ishin zhvilluar politika dhe udhëzime të veçanta për reformim të kurrikulave, pos një urdhërese për ndarje të lëndëve të vitit në semestra dhe për shndërrimin linear të programeve të ciklit të parë nga katër vjeçare në studime trivjeçare. Përkundër këtyre mangësive, UP-ja ishte ndër institucionet e para të arsimit të lartë në rajon që i kishte hyrë një procesi të gjithëmbarshtëm të reformimit sipas objektivave të Bolonjës, duke bërë përpjekje për zbatimin e objektivave dy dhe tre¹. Kjo periudhë karakterizohet edhe nga vështirësi në hartimin e kurrikulave dhe në zbatimin e ciklit të dytë të studimeve për master.

Një gjendje e këtu ka vazhduar deri në vitin akademik 2006 / 2007. Gjatë këtij viti udhëheqja e UP-së bëri rishikimin e planeve mësimore duke vendosur një lidhje më të mirë të kredive ECTS me ngarkesën e punës së studentit dhe konsolidimit të silabuseve bazuar në proceset evropiane të harmonizimit (TUNING²) të kurrikulave. Në anën tjetër,

¹ ECTS-ja dhe futja në zbatim i dy niveleve/cikleve të studimeve – bachelor dhe master.

² Tuning është një program i mbështetur nga Komisioni Evropian që synon harmonizimin e strukturave të nxënies dhe të procedurave të instrumenteve të hartimit të kurrikulave. Kjo metodologji e

institucionet private të arsimit të lartë kanë hartuar kurrikulat e veta duke u bazuar kryesisht në ato të UP-së, si dhe në disa raste duke u mbështetur në kurrikulat e rajonit por edhe më gjerë. Në këtë kuptim përjashtim bën Universiteti Amerikan i Kosovës, i cili bazohet në sistemit amerikan të studimeve. Universiteti tjetër publik në veri të Mitrovicës ka bërë përpjekje për reformim të programeve studimore, të cilat kanë dështuar për shkak të ndërhyrjes flagrante të politikës (së qeverisë serbe) në strukturën udhëheqëse të universitetit.

Në fund të vitit akademik 2006/2007 UP-ja ka vendosur të fillojë procesin e konsolidimit të kurrikulave dhe të zbatimit të studimeve të ciklit të dytë sipas Bolonjës. Këto procese në UP janë zhvilluar duke u bazuar në vendimet përkatëse të Senatit të UP-së të cilat ofrojnë edhe kornizën orientuese për këto procese. Në të njëjtën kohë, komisioni përkatës ka hartuar, ndërsa Senati i UP-së e ka miratuar, rregulloren për studimet e ciklit të tretë (të doktoratës), në zbatim të objektivit të dhjetë të Bolonjës. Po ashtu, UP-ja ka themeluar Njësinë për Sigurimin e Cilësisë, e cila ka për detyrë të përcjellë sigurimin e cilësisë në të gjitha aspektet e funksionimit të saj, me theks të veçantë cilësinë e kurrikulave.

Në të gjitha këto zhvillime, UP-ja ka siguruar përfshirje të plotë dhe pjesëmarrje aktive të tërë komunitetit akademik. Kështu, 4 prej 11 anëtarëve të Komisionit të studimeve në Universitet dhe janë studentë (të përfaqësuar pos kësaj edhe në komisionet e njësive akademike), gjë që ka ndikuar në përmbushjen e objektivit të tetë për përfshirjen e studentëve në ndryshimet kurrikulare.

II. Qasje sistematike për integrim në trendet evropiane të arsimit të lartë

Procesi i zhvillimit të kurrikulave në IAL-të në Kosovë do të zhvillohet në harmoni të plotë me proceset përkatëse në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Në zbatim të këtij procesi institucionet e arsimit të lartë në Kosovë do të udhëhiqen nga **parimet** në vijim:

- Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike;
- Udhëheqje e menaxhim i procesit nga institucionet dhe personeli arsimor
- Respektimi i interesave të studentëve dhe sigurimi i pjesëmarrjes së tyre aktive në këtë proces;
- Integrimi në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL)

Qeveria/MASHT dhe institucionet e arsimit të lartë (publike e private) do të sigurojnë të gjitha kushtet e resurset akademike, financiare, materiale e fizike për themelimin e programeve të reja ose për funksionimin e programeve ekzistuese. Njëkohësisht, gjatë hartimit të programeve do t'i kushtohet vëmendje e veçantë disenjimit dhe zbatimit cilësor të tyre.

Programet e studimeve do të jenë të qarta, të lexueshme, të matshme, të krahasueshme dhe, si të tilla, në funksion të lehtësimit të procesit të vlerësimit e të akreditimit.

vë theksin në kompetenca, rezultate të nxënies dhe në lidhjen e kredive ECTS me ngarkesën e punës së studentit.

Këto programe do të bazohen në:

- a) hulumtimin e mirëfilltë të nevojave dhe të rrjedhave të tregut në vend dhe më gjerë;
- b) vlerësimin e prioriteteve zhvillimore kombëtare;
- c) një proces të mirëfilltë të konsultimeve me palët e interesuara;
- d) potencialin ekzistues akademik.

III. Qëllimi dhe objektivat e procesit

Sigurimi i një procesi koherent dhe transparent për hartimin e kurrikulave në përputhje me objektivat e procesit të Bolonjës, me praktikën më të mira në rajon e në Evropë dhe vendosja e një lidhjeje logjike ndërmjet synimeve të sistemit të arsimit të lartë dhe standardeve të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në një proces të konsultimeve aktive me partnerët socialë.

Ky qëllim do të realizohet mbi bazën e këtyre objektivave:

- Të identifikohen nevojat e tregut dhe të shoqërisë për profesionistë në fusha të caktuara dhe të stimulohen hartimi i kurrikulave atraktive dhe në lëmenjtë deficitarë, si dhe në fushat me rëndësi të veçantë shoqërore;
- Të themelohen drejtime dhe profile të reja studimore mbi bazën e nevojave të përcaktuara dhe në bazë të mundësive duke ruajtur nivelin e cilësisë, si dhe të zgjerohet spektri i shërbimeve arsimore në fushën e arsimit tërëjetësor;
- Të përfillen ecuritë dhe procedurat e qasjes dhe metodologjisë evropiane Tuning në procesin e hartimit të programeve studimore dhe të kurrikulave duke përcaktuar rezultatet e nxënies të shprehura në kompetenca gjenerike dhe specifike të profileve të caktuara³;
- Të sigurohen programe më fleksibile dhe më të individualizuara të studimeve përmes organizimit të tyre në module dhe në njësi të kurseve;
- Të hartohen dhe të miratohen, përmes një qasjeje koherente, programet studimore për të tri nivelet e studimeve⁴;
- Të standardizohet terminologjia profesionale në fushën e kurrikulave në gjuhët studimore dhe të bëhet vetëdijesimi e aftësimi i personelit në këtë fushë.

IV. Implikimet e mundshme të politikës

Kosova, në rrugën e saj për integrim në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, është përcaktuar fuqimisht për përmbushjen e objektivave të Procesit të Bolonjës. Çfarëdo opsioni tjetër do të zhvlerësonte angazhimet e komunitetit akademik kosovar dhe të

³ Në procesin e hartimit dhe rishkrimit të programeve të veta studimore dhe të planprogrameve të veta IAL-të në vazhdimësi do t'i kushtojnë kujdes të veçantë sigurimit të koherencës ndërmjet deskriptorëve, kompetencave gjenerike dhe atyre specifike lëndore dhe rezultateve të nxënies.

⁴ Në përputhje me objektivin e 10 të Procesit të Bolonjës i cili është trajtuar në veçanti gjatë punimeve të konferencave të ministrave evropian të arsimit në Bergen (2005) dhe në Londër (2007).

udhëheqjes arsimore gjatë decenies së fundit dhe orientimin pro-evropian të tredeve arsimore në Kosovë.

Fakti që Kosova nuk është pranuar në familjen e vendeve nënshkruese të Deklaratës së Bolonjës (për arsye të statusit të pazgjidhur politik), nuk i zbeh përpjekjet dhe vendosmërinë tonë për integrim të plotë edhe formal në këtë proces. Bazuar në përvojën e disa viteve të kaluara, ky proces integrues mund të has në rezistenca të ndryshme qoftë për arsye konceptuale (për shkak të qëndrimit personal ndaj Procesit Bolonjës) ose, përveç tjerash, për arsye të ecurisë dhe ritmit të shpejtë të ndryshimeve.

Funksionimi jo i mirë ose, në disa raste, edhe mosekzistimi i organeve përkatëse drejtuese dhe profesionale në disa institucione private të arsimit lartë mund të ndikojë negativisht në implementimin e kësaj politike dhe në integrimin e tyre në familjen e në rrjedhat përkatëse të universiteteve evropiane. Kufizimet buxhetore në fushën e arsimit, si rezultat i bruto-prodhimit të ulët kombëtar, mund të ngadalësojnë ritmin e zhvillimit dhe të ndryshimeve.

Ky orientim i komunitetit akademik kosovar do të lehtësojë procesin e integritit të shoqërisë kosovare në familjen e vendeve të Bashkimit Evropian nëpërmjet:

- zhvillimit të resurseve njerëzore dhe zhvillimit ekonomik të vendit,
- afirmimit të vlerave demokratike evropiane,
- rritjes së kohezionit social,
- afirmimit të tolerancës, multikulturalitetit, edukimit inkluziv dhe global si dhe krijimit të shoqërisë së bazuar në dije.

V. Plani dhe masat për zbatim

Me qëllim të arritjes së objektivave të sipërpërmendura, MASHT dhe IAL-të do të angazhohen për ndërmarrjen e një sërë masash. Kjo nënkupton një sërë masash në fushat në vijim:

a) Masat për ndërtimin e kapaciteteve:

- Hartohen mekanizmat dhe instrumentet përkatëse për hulumtimin e nevojave të tregut dhe shoqërisë për profesionistë në lëmenj të caktuar.
- IAL-të do të vendosin mekanizmat institucionalë për ndërtimin e kapaciteteve në hartimin e kurrikulave sipas qasjes dhe metodologjisë Tuning.
- Sigurohen fonde për zhvillim profesional e vizita studimore jashtë vendit përkitazi me procesin Tuning.

b) Masat stimuluuese:

- MASHT dhe IAL-të publike do të ndërmarrin masa stimuluuese për profesionet deficitare dhe për ato me rëndësi të veçantë shoqërore (si për shembull lirim nga pagesa për studime, dhënia e bursave, lehtësime për strehim, literaturë, shpenzimet e udhëtimit, etj);

- Qeveria / MASHT gjatë licencimit u jep përparësi profileve dhe IAL-ve të cilat ofrojnë programe të reja, atraktive, konkurruese dhe që janë në përputhje me kërkesat e tregut dhe me nevojat e veçanta të shoqërisë;
- Organizohen tryeza, diskutime, anketa, tribuna, debate me komunitetin akademik dhe palët e interesuara, si dhe shtypen broshura, fletëpalosje dhe materiale të tjera promovuese lidhur me procesin e hartimit të kurrikulave.

c) Masat për sigurimin e cilësisë dhe krahasueshmërisë së programeve:

- Rishikimi i kurrikulave ekzistuese dhe harmonizimi i tyre sipas metodologjisë dhe qasjes Tuning (deri në vitin 2009);
- Njësitë akademike do të bëjnë përmirësimin dhe avansimin e rregullt të planprogrameve të veta me qëllim të sigurimit të cilësisë dhe të përcjelljes së zhvillimeve akademike në fushën përkatëse shkencore;
- IAL-të do të rishikojnë në mënyrë periodike kurrikulat e njësive akademike me qëllim të përcjelljes në vazhdimësi të ndryshimeve dhe zhvillimeve teknologjike;
- MASHT formon një grup gjithëpërfshirës të ekspertëve me qëllim të standardizimit të terminologjisë në fushën e kurrikulave.

d) Zgjerimi i ofertës arsimore

- Deri në vitin 2010 të gjitha IAL-të e autorizuar do të përfshihen në procesin e zhvillimit të kurrikulave dhe në zbatimin të studimeve në ciklin e tretë duke përfshirë bashkëpunimin me organizata e entitetete të tjera në zhvillimin e hulumtimeve shkencore;
- Programi i aftësimi pa shkëputje nga puna do të funksionojë si program i përhershëm dhe e zgjeron spektrin e shërbimeve për të përfshirë edhe profesione të tjera gjithnjë duke i respektuar kriteret dhe procedurat akademike;
- Institucionet e arsimit të lartë do të angazhohen për diversifikimin dhe zgjerimin e shërbimeve arsimore në sektorin jouniversitar, në fushën e formimit tërëjetësor dhe në fushën e shkencave të aplikuara.

Në procesin e zbatimit të kësaj politike, për arsye të ndryshme, mund të priten ngurrime, qasje pasive, neglizhencë, madje edhe kundërshtime. Qëndrime të këtilla mund të vijnë si nga personeli mësimdhënës, ashtu edhe nga studentët si përfitues të fundit të shërbimeve arsimore. Me qëllim të tejkalimit të këtyre pengesave MASHT, IAL-të, Parlamenti i Studentëve të UP-së dhe organizata të tjera studentore do të organizojnë tryeza, debate, vizita studimore, aktivitete për informim dhe ngritje të kapaciteteve, rritje të mobilitetit të studentëve dhe mësimdhënësve dhe masa të tjera stimuluese që inkurajojnë komunitetin akademik për pjesëmarrje aktive në këto procese.

VI. Buxheti:

Kurrikulat cilësore, të zbatueshme dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës e të shoqërisë janë ndër shtyllat kryesore për një sistem efikas e efektiv të arsimit të lartë. Kjo politikë, bashkë me dokumentet e tjera përcjellëse, mundëson lëvizjen në drejtim të avansimit të cilësisë së këtyre kurrikulave. Megjithatë për zbatimin e kësaj politike duhet të sigurohen edhe fonde plotësuese nga MASHT-i, IAL-të dhe nga donatorët e

ndryshëm pasi nënkupton edhe angazhime shtesë nga komuniteti akademik, nga ekspertët e arsimit dhe nga partnerët ndërkombëtarë. MASHT dhe UP do të angazhojnë Grupin e Promotorëve të Bolonjës për hartimin e planit zbatues të kësaj politike, për bashkërenditjen e veprimeve për sigurimin e fondeve dhe për zbatimin e saj në periudhën 2008 – 2010.

VII. Vlerësimi dhe monitorimi i zbatimit

Për shqyrtimin e efekteve të procesit të kurrikulave do të bëhet vlerësimi i brendshëm vjetor dhe një vlerësim i jashtëm përmbledhës (në vitin 2010). Njësitë akademike do të përfshijnë studentët në procesin e vlerësimit të brendshëm për të konstatuar ngarkesën reale të punës dhe përmbajtjen e metodologjinë e programeve. Kjo do të bëhet edhe duke përcjellë të diplomuarit në periudha të caktuara pas diplomimit, shkallën e dinamikën e punësimit të tyre, si dhe efikasitetin e dijeve të fituara. Ky vlerësim do të zgjerohet për të përfshirë edhe punëdhënësit e tyre e partnerët socialë me qëllim të informimit për cilësinë e punës së të diplomuarve. Vlerësimi i jashtëm do të kryhet nga agjenci të pavarura e të autorizuara për këtë qëllim (sipas udhëzimeve të ENQA-s). Vlerësimet do të përdoren për konstatimin e gjendjës dhe korrigjimin eventual të procesit të hartimit të kurrikulave dhe për ngritjen e cilësisë së tyre.

Në vitin 2010 MASHT do të organizojë një vlerësim gjithëpërfshirës për të konstatuar:

- a) zbatimin e këtij dokumenti dhe pjesëmarrjen e palëve të involvuara;
- b) shkallën e plotësisimit të nevojave të tregut dhe të shoqërisë nga profesionistët e diplomuar në institucionet e arsimit të lartë;
- c) nivelin e punësueshmërisë së të diplomuarve, si dhe
- d) performancën e IAL-ve.

Në bazë të rezultateteve e të rekomandimeve nga ky vlerësim, MASHT dhe IAL-të do të ndërmarrin masa në vazhdimësi për harmonizimin e të gjitha programeve studimore, strukturave të studimeve dhe kurseve me kërkesat e procesit të Bolonjës dhe të sigurimit të cilësisë së arsimit të lartë.



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Kabineti i Ministrit

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

Minister's Cabinet

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabinet Ministra

KRITERET E PËRBASHKETA PËR IMPLEMENTIMIN E ECTS NË ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË

I. Hyrje

Në vitin akademik 2001/2002 në UP është aprovuar struktura e studimeve 3+2+3 dhe ka filluar implementimi i sistemit europian për transferin dhe akumulimin e kredive (ECTS).

Që nga viti 2003, Kosova ka marrë pjesë në konferencat e Procesit të Bolonjës në cilësinë e vëzhguesit. Edhe pse jo anëtare e plotë, autoritetet kosovare dhe IAL-të janë të vendosura në implementimin e plotë të kërkesave që dalin nga Procesi i Bolonjës. Ligji për arsimin e lartë, i miratuar në vitin 2003, gjithashtu i referohet Deklaratës së Bolonjës dhe kërkon që të gjitha IAL-të të punojnë në përputhje me këtë deklaratë. Në vitin 2004 është hartuar Strategjia për zhvillimin e arsimit të lartë, e cila i merr në konsideratë të gjitha kërkesat që dalin prej Procesit të Bolonjës. Po ashtu, statutet e të gjitha IAL-ve i referohen Deklaratës së Bolonjës në pjesën që ka të bëjë me ECTS.

Prej vitit 2005, UP ka themeluar njësinë për ECTS dhe ka zgjedhur koordinatoren institucional për ECTS dhe koordinatorët për secilën njësi akademike. Kjo ishte një nismë pozitive dhe ka ndihmuar në shpërndarjen e informacioneve të sakta mbi mënyrën e alokimit të kredive.

Me gjithë zhvillimet pozitive sa i përket ECTS, ende mungon një qasje unike në implementimin e ECTS në programe të njëjta nëpër IAL të ndryshme. Ky dokument ka për qëllim të ofrojë parimet bazë për implementimin e plotë të ECTS në të gjitha IAL.

II. Qëllimi i dokumentit

Në bazë të Ligjit mbi arsimin e lartë, neni 4 dhe Strategjisë për zhvillimin e arsimit të lartë 2005-2015, si dhe "Udhëzuesit për përdorimin e ECTS-së" (ECTS User's Guide) të Komisionit Evropian, për implementimin dhe funksionalizimin e ECTS-së, në këtë dokument, Ministria rekomandon kriteret e përgjithshme për vlerësimin e programeve të

studimit sipas ECTS-së.

Ky dokument përmban kriteret për vlerësimin e programeve të studimeve sipas ECTS-së dhe do të shërbejë si bazë për implementimin e plotë të ECTS-së në të gjitha IAL-të (private dhe publike).

III. Qëllimi i ECTS-së

ECTS-ja është sistem për transfer dhe akumulim të kredive, i orientuar kah studentit dhe paraqet ngarkesën e studentit për të arritur objektivat e një programi të caktuar të studimit.

Ky sistem lehtëson njohjen e periudhës së studimit në institucionet tjera (në vend dhe jashtë), transferin e kredive të akumuluar nga një IAL në tjetrin dhe kështu mundëson mobilitet të shtuar të studentëve në Europë.

ECTS-ja mundëson që programet studimore të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të krahasueshme dhe i ndihmon IAL-të të hartojnë dhe t'i rishikojnë programet e tyre studimore.

IV. Kredia

Kredia është njësia matëse e punës që duhet ta kryejë studentit (ngarkesa e punës së studentit) për arritjen e objektivave dhe rezultateve të të nxënimit në lëndën (modulin) e caktuar. Një kredie i përgjigjen 25 deri në 30 orë ngarkesë, andaj ngarkesa e studentit për një vit akademik është 1500 deri në 1800 orë.

Në ngarkesën e studentit përfshihen:

- Ligjëratat,
- Ushtrimet,
- Kontaktet me mësimdhënësin,
- Puna praktike dhe laboratorike,
- Puna në terren,
- Kollokviumet, kuizet, seminarët,
- Detyrat për kërkim në bibliotekë,
- Koha e studimit individual,
- Projektet, elaboratet etj
- Përgatitja për provim dhe koha e mbajtjes së provimit,
- Përgatitja e punimit perfundimtar (tema e diplomës).

Studenti i fiton kreditë vetëm pasi t'i ketë përfunduar të gjitha obligimet e parapara të një programi.

Mënyrën e përlogaritjes së numrit të kredive për lëndët e caktuara të programit të studimeve e cakton IAL-ja.

V. Ciklet e studimit dhe ECTS-ja

Programi i studimit duhet të përpilohet ashtu që një vit i studimit të ketë 60 kredi (30 kredi për semestër). Secila lëndë duhet të vlerësohet me numër të caktuar të kredive.

Në ciklin e parë të studimeve (bachelor) duhet të akumulohen 180-240 kredi.

Në ciklin e dytë të studimeve (master) duhet të akumulohen 60-120 kredi, ashtu që në fund të ciklit të dytë i diplomuari të ketë mbledhur të paktën 300 kredi.

Në ciklin e tretë të studimeve (studimet e doktoratës) duhet të akumulohen 180 kredi.

Kohëzgjatja e programeve të veçanta të studimeve (mjekësia, farmacia, veterina etj.) duhet të përputhet me direktivat e Komisionit Evropian në lidhje me ato programe.

VI. Dokumentet për implementimin e ECTS-së

Me qëllim të implementimit të plotë të ECTS-së, secili IAL duhet që:

- a. Në statut të përfshijë sistemin ECTS-së,
- b. Të përpilojë Pakon informative për ECTS-në (të dhënat për IAL, programet e studimeve, përshkrimin e lëndëve dhe numrin e kredive dhe të dhënat mbi afatet e provimeve dhe mënyrat e vlerësimit),
- c. Të shfrytëzojë/ përgatisë këto dokumente:
 - formën standarde të aplikimit të studentit për mobilitet,
 - marrëveshjen e mësimit,
 - transkriptin e notave, dhe
 - aktet tjera të nevojshme.

Përrjashtim nga kjo rregull bëjnë IAL-të që operojnë në bazë të marrëveshjeve me institucione të arsimit të lartë ose janë të akredituara nga autoritete akreditimi të vendeve ku nuk aplikohet ECTS.

VII. Implementimi i këtij dokumenti

Me qëllim të implementimit të këtij dokumenti duhet të ndërmerren këto masa:

- MASHT të përgatisë udhëzim administrativ (UA) për implementimin e këtij dokumenti,
- Në afat prej 6 muajsh prej nxjerrjes së udhëzimit administrativ, IAL-të të përgatisin të gjitha dokumentet e parapara për ECTS ,
- AAK në rregulloret për akreditim përcakton kriteret me të cilat kërkon nga IAL-të të përgatisin dokumentet e nevojshme për ECTS,
- Sipas nevojës organizohen seminare dhe trajnime për ECTS për të gjitha IAL-të.

VIII. Vlerësimi

MASHT do të organizojë një vlerësim të pavarur të implementimit të këtij udhëzimi dhe të Udhëzimit përkatës Administrativ një vit pas nënshkrimit të UA-së. Institucionet publike të arsimit të lartë do të përfshijnë informata për zbatimin e këtij udhëzimi dhe të dipozitave të tjera përkatëse në raportet e tyre vjetore për MASHT dhe në raportet eventuale për AAK-në. Edhe institucionet private të AL do të hartojnë e dorëzojnë raporte në MASHT lidhur me zbatimin e ECTS-së, me rastin e vlerësimeve të ndryshme, akreditimit apo licencimit të veprimtarisë.



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Minister's Cabinet

Kabinet Ministra

UDHËZIME TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË PËR

VLERËSIMIN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TE LARTE NE KOSOVE

I. Hyrje

Tetë vjet pas Deklaratës së Bolonjës jemi dëshmitar të një Procesi shumë të fuqishëm që tashmë e ka kapluar arsimin e lartë në shumicën e vendeve evropiane. Me skemat e veta të mobilitetit, me nisma e programe të shumta të shkëmbimit, me njohjen e dokumenteve, akumulimin dhe bartjen e studimeve dhe të përvojave të të nxënies, ky proces i reformave të strukturave arsimore është bërë një nga “indet e gjalla lidhëse” të proceseve integruese evropiane. Megjithatë, nëse njëmend synohet funksionimi i mirëfilltë i këtij indi lidhës, atëherë është e domosdoshme të zhvillohen deskriptorë të ndryshëm, standarde, rezultate të nxënies, kompetenca dhe pika të tjera referimi për t'i bërë studimet gjithandej Evropës të matshme, të krahasueshme dhe transparente. Element tjetër i rëndësishëm është sigurimi i shërbimeve cilësore të arsimit të lartë në mbarë Evropën. Edhe këtu duhen mekanizma dhe procedura për të siguruar programe cilësore të studimeve nga të cilat do të rrjedhnin kualifikime e diploma cilësore që do të ofronin shkathtësitë, kompetencat dhe dijet e nevojshme për tregun e punës e për shoqëritë e dijes së epokës së re.

Në kohën kur shumica e vendeve evropiane i kanë plotësuar shumicën e kërkesave në fushën e sigurimit të cilësisë, institucionet dhe agjencitë e tjera kosovare të arsimit të lartë, secila në fushën e vet, do të duhet të dyfishojnë përpjekjet e veta për të qenë sa më afër zhvillimeve në vendet e tjera. Në këtë kuptim, ato duhet të zhvillojnë mekanizmat dhe procedurat e veta për vetëvlerësim dhe vlerësim të brendshëm, të fillojnë zbatimin e proceseve dhe aktiviteteve për vlerësim të jashtëm dhe, të gjithë së bashku, të ndërtojnë një sistem transparent, efikas dhe efektiv të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë. Edhe pse, për arsye të ditura politike, Kosova formalisht ende nuk është anëtare e Procesit të Bolonjës, ajo i njeh dhe i zbaton Standardet dhe

Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, të cilat ishin miratuar nga ministrat përgjegjës për arsimin e lartë në Konferencën e Bergenit në vitin 2005.

Vlerësimi i IAL-ve është shumë i rëndësishëm pasi që ndihmon në krijimin e kushteve për të siguruar cilësinë në arsimin e lartë. Ky dokument në njërin anë ofron udhëzimet e përgjithshme për institucionet e arsimit të lartë që ato të kyçen në mënyrë më aktive në vetëvlerësim dhe vlerësim të brendshëm, dhe në anën tjetër e përshkruan mënyrën në të cilën do të kryhet procesi i vlerësimit në Kosovë si pjesë e përpjekjeve për vlerësim të jashtëm (që do të vijë kryesisht nga ana Agjencisë për Akreditim të Kosovës).

II. Parimet dhe synimet

Kosova duhet të angazhohet në një proces të përshpejtuar të vlerësimeve të brendshme e të jashtme, për të qëndruar sa më afër vendeve të tjera në rajon dhe më gjerë në Evropë në fushën e vlerësimeve.

Vendosja e mekanizmave dhe procedurave të duhura për vlerësim të brendshëm e të jashtëm dhe zbatimi i tyre adekuat dhe i përshpejtuar është opsion (dhe sfidë) kyç me të cilin përballen Ministria e Arsimit dhe institucionet e arsimit të lartë në rrugën e tyre të ndërtimit të sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në harmoni me objektivat dhe kahet e veprimit të Procesit të Bolonjës.

III. Qëllimet kryesore

Këto udhëzime mëtojnë të shërbejnë si udhërrëfyes si për institucionet e arsimit të lartë, ashtu edhe për agjencitë e qeverisë në mënyrë që:

- Të vendosen themelet e të krijohen kushtet për një proces efikas dhe objektiv të akreditimit;
- Të përmirësohen proceset, procedurat, mekanizmat dhe të zhvillohet një kulturë e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të brendshëm në institucionet e arsimit të lartë;
- Të bëhen kurrikulat dhe programet më transparente, të lexueshme dhe lehtë të krahasueshme për të mundësuar kryerjen e vlerësimeve më të lehta të institucioneve dhe të programeve;
- Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm të shërbejë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.

IV. Udhëzimet për implementim:

Vlerësimi i mësimdhënies e të nxëniet është një proces i gjykitimit dhe çmuarjes së cilësisë dhe përshtatshmërisë së procesit të të nxëniet, përfshirë performancën e mësimdhënësve dhe qasjen pedagogjike.

IV.1. Vlerësimi I brendshëm

Vlerësimi i brendshëm është një proces i pandërprerë i brendshëm i secilit institucion të arsimit të lartë që zhvillohet duke aplikuar një sërë udhëzimesh të parashtruara në Standardet dhe Udhëzimet Evropiane (SUE). Qëllimi kryesor i këtij procesi është përmirësimi i kulturës së cilësisë brenda IAL-së. Më poshtë janë dhënë aspekte të vlerësimit të brendshëm që do të shërbejnë si rekomandime për institucionet e arsimit të lartë kur të vendosin procedurat e veta të vlerësimit të brendshëm:

- Vlerësimi i brendshëm do të orientohet në drejtim të monitorimit e të analizës së një numri të segmenteve:
 - misioni dhe qëllimet e IAL-së;
 - strategjia e arritjes së misionit;
 - përshkrimi i institucionit të arsimit të lartë që ofron aktivitete të arsimit të lartë;
 - programi i studimeve dhe kurset lëndore;
 - mësimdhënësit dhe asistentët;
 - aktivitetet e mësimdhënies e të të nxënit;
 - studentët;
 - objektet dhe kushtet materiale (resurset);
 - logjistika;
 - bashkëpunimi i jashtëm;
 - aktivitetet e kërkimeve shkencore;
 - financimi.
- Nga këto segmente, misioni dhe strategjia duhet të përcaktohen nga ana e komunitetit universitar dhe të çmohet e të vlerësohet rregullisht me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe të rezultateve. Vetëvlerësimi është një raport i brendshëm i thukët për përdorim të jashtëm. Kryesore në këtë kontekst është që secili institucion i arsimit të lartë duhet të themelojë dhe të mirëmbajë një strukturë të përhershme për vlerësim të brendshëm, si dhe një grup për qëllimet e vlerësimit të jashtëm.

IV.2. Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është proces i shqyrtimit kritik të shërbimeve dhe të performancës së një institucionit nga vetë personeli i atij institucioni.

Vetëvlerësimi mund të ndërmerret në bazë individuale ose, në kontekst të shqyrtimit për vlerësim të jashtëm, në bazë kolektive.

Vetëvlerësimi ndërvepron me vlerësimin e brendshëm në kontekstin e cilësisë së arsimit të lartë.

Që të dyja kanë të bëjnë me një proces të vetëreflektimit nga ana e një institucioni ose nga njësitë e tij, si dhe me përgatitjen e një dokumenti si rezultat i këtij vetëreflektimi.

Vetëvlerësimi kryhet para një vlerësimi të jashtëm (ky në një mënyrë është pjesë e vlerësimit të jashtëm, ndërkohë që është rezultat i vlerësimit të brendshëm).

IV.3. Vlerësimi i jashtëm

Për shkak të situatës specifike të Kosovës, ku shumica e personelit akademik janë në një mënyrë apo tjetër drejtëpërsëdrejti të lidhur me Universitetin e Prishtinës, çdo vlerësim i jashtëm i ndërmarrë në Kosovë duhet të shërbehet me ekspertizë të jashtme qoftë nga rajoni apo me gjerë nga vendet e tjera evropiane për shumicën e fushave akademike. Në këtë kuptim, Kosova është thelbësisht e intersuar për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e vlerësimit. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë që secili ekip vlerësues duhet të përbëhet prej së paku një eksperti nga rajoni dhe nga një ekspert prej ndonjë vendi tjetër evropian.

Aspekte të tjera themelore të vlerësimit të jashtëm janë:

- Kërkohe vetëvlerësimi nga ana e secilit institucion të arsimit të lartë si hap i parë i vlerësimit të jashtëm;
- Vetëvlerësimi dhe vizitat nga ekipet e jashtme vlerësuese përbëjnë thelbin e raporteve të jashtme vlerësuese;
- Në secilin IAL duhet të kryhen dy nivele të vlerësimit:
 - vlerësimin institucional dhe
 - vlerësimin e programit
- Një ose dy vizita të ekipit vlerësues pas prezentimit të vetëvlerësimit;
- Përbërja e ekipeve të jashtme vlerësuese:
 - Secili ekip përbëhet nga 3 deri 5 anëtarë, varësisht nga madhësia e universitetit⁵
 - Secili ekip ka së paku 1 ose 2 anëtarë ndërkombëtarë
 - Vlerësuesit nuk duhet të kenë kurrëfarë relacionesh me IAL-në e vlerësuar
 - Studentët duhet të jenë të përfaqësuar disi në ekipet vlerësuese
 - Kryesuesi i secilit ekip do të jetë ndërkombëtar
- Do të ketë diskutime ndërmjet ekipit vlerësues dhe institucionit të vlerësuar
- Ekipet e vlerësimit do t'i dorëzojnë raportet e veta në Këshillin e AAK-së.

Secili institucion i licencuar i AL duhet të vlerësohet së paku në çdo 4 deri 5 vjet. Procesi i vlerësimit do të zgjasë një vit akademik dhe raportet e vlerësimit të jashtëm do të botohen. Raportet vlerësuese japin një pasqyrë të cilësisë për secilin IAL dhe i shërbejnë më tej ministrisë për të sjellur vendime të informuara lidhur me licencat e tyre.

IV.4. Vizitat në institucione

Vizitat në institucione ndodhin kur një ekip i jashtëm vlerësues shkon në një institucion për të vlerësuar dëshmitë gojore, të shkruara dhe pamore.

Qëllimi i vizitave në institucione është që të vëzhgohen objektet, ndërveprimi ndërmjet personelit dhe studentëve, qasja në dokumentacione, mbikqyrja e dëshmimeve konkrete

⁵ Madhësia e universitetit nënkupton:

- numrin e studentëve
- numrin e programeve
- strukturën (strukturën gjeografike, degët, lokacionet)

për arritshmërinë e studentëve dhe kontrollimi i vërtetësisë së deklaratave të vetëvlerësimit.

V. Agjencitë kryesore implementuese

Së bashku me institucionet e arsimit të lartë (të cilat kanë rol thelbësor në të gjitha aspektet e vlerësimit, e sidomos në vlerësimin e brendshëm dhe në vetëvlerësim), Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe MASHT-i kanë rol kyç në planifikimin, bashkërenditjen dhe në mundësimin e implementimit të këtij udhëzimi. Këto institucione e shohin vetën para së gjithash në rol këshillues, udhëzues, ndihmës, mundësues e rekomandues. Megjithatë, këto janë përgjegjëse për të siguruar që shoqërisë i ofrohen shërbimet më të mira, më efikase dhe më efektive të arsimit të lartë. Në këtë kuptim atoduhet të angazhohen edhe në rol mbikqyrës dhe bashkërenditës.

V.1. Roli i Agjencisë Kosovare të Akreditimit

Agjencia e Akreditimit është përgjegjëse për procesin e vlerësimit, duke u ofruar shërbime të tilla të gjitha institucioneve të AL në Kosovë. AAK do të autorizojë dhe do të bashkërenditë vlerësimin e jashtëm, do të mbikqyrë dhe do të ndihmojë institucionet e arsimit të lartë në kryerjen e vlerësimit të brendshëm. Agjencia e Akreditimit nuk bënë kurrëfarë dallimi ndërmjet institucioneve publike dhe atyre private.

Agjencia do të angazhohet për të plotësuar kriteret dhe kërkesat për t'u bërë anëtare e ENQA-s në mënyrë që të përfshihet në Regjistrin Evropian të agjencive të akreditimit. Për të arritur një gjë të tillë, Agjencia duhet të konkurrojë për anëtarësi, por çka është edhe më me rëndësi, ajo duhet të arrijë dhe të ruajë standarde të larta të funksionimit e të veprimtarisë. Kjo nënkupton që edhe Agjencia e Akreditimit e Kosovës do t'i nënshtrohet proceseve të vlerësimeve të jashtme institucionale në mënyrë periodike.


V.2. Struktura dhe detyrat e Agjencisë së Akreditimit

- AAK ka Këshillin e vet dhe një zyrë për mbështetje administrative
- Anëtarët e Këshillit caktohen nga Ministria
- Këshilli përbëhet prej tre anëtarëve ndërkombëtarë dhe prej gjashtë ekspertëve kosovarë
- AAK i harton rregulloret dhe procedurat e punës
- AAK duhet të informojë të gjitha IAL-të për procedurat dhe kriteret e vlerësimit
- AAK ofron ndihmë gjatë vlerësimit për të gjitha IAL-të
- AAK i cakton afatet kohore të veprimeve
- Këshilli i AAK-së i bënë rekomandimet përkatëse për vlerësimet e veta në Ministri
- Raportet e AAK-së publikohen
- AAK-ja i përcjellë rekomandimet e raportit të jashtëm vlerësues

V.3. Roli i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Roli i MASHT-it është i paraparë në Ligjin për Arsimin e Lartë 2003/13; në përputhje me dispozitat e këtij Ligji. MASHT-i do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Akreditimit për të siguruar shërbime cilësore të sistemit dhe të institucioneve të arsimit të lartë. MASHT-i do të mbështesë funksionimin e Agjencisë gjatë tri vjetëve të para të veprimtarisë së saj. Gjatë kësaj periudhe, Agjencia do të ndihmohet që të bëhet e pavarur, që të krijojë dhe funksionojë me të hyrat vetanake, si dhe të shndërrohet në garanci të cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë - anëtare e respektuar e Regjistrit Evropian të agjencive për sigurimin e cilësisë. MASHT-i po ashtu do të angazhohet në mënyrë aktive që të krijojë kushte të përshtatshme pune për institucionet e akredituara të arsimit të lartë. Në harmoni me objektivat dhe masat e parapara në Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit të Lartë 2005 – 2015, Ministria do të angazhohet për realizimin e ndryshimeve sistemore dhe për rishikimin e përditësimin e kornizës ligjore me qëllim që të sigurojë procese dhe legjislacion në harmoni me aspektet përkatëse evropiane në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

VI. Modeli i organizimit të punës



Shkurtesat

IAL Institucion i Arsimit të Lartë
AAK Agjencia për Akreditim e Kosovës
MASHT Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrisë

Minister's Cabinet

Kabinet Ministra

POLITIKA E MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË PËR

KRAHASUESHMËRINË DHE NJOHJEN E DIPLOMAVE E TË PROGRAMEVE STUDIMORE TË PARA-BOLONJËS DHE TË BOLONJËS

HYRJE

Tërë legjisllacioni dhe politikat e tjera në fushën e arsimit të lartë në Kosovë i referohen qartë Deklaratës së Bolonjës dhe Konventës së Këshillit të Evropës / UNESCO-s për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë. Ligji nr. 2003/14 për Arsimin e Lartë në Kosovë, i hartuar nën mbikqyrjen e rreptë të Këshillit të Evropës është në harmoni të plotë me Deklaratën e Bolonjës dhe me dokumentet pasuese të këtij procesi. Ky kërkon nga arsimit i lartë i Kosovës që të zhvillohet në drejtim të qëllimeve të përcaktuara nga Procesi i Bolonjës. Njëkohësisht, Kosova merr pjesë aktive në të gjitha proceset relevante në arsim, përfshirë edhe procesin e hartimit të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve; në këtë kontekst, Ligji për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve i ka kaluar procedimet në Qeveri dhe është përcjellur në Kuvendin e Kosovës, ku pritet miratimi i tij i shpejtë.

Struktura organizative e arsimit të lartë në Kosovë ka ndryshuar që nga viti 1999. Këto ndryshime, pos tjerash, kanë synuar që ta bëjnë sistemin e arsimit të lartë në Kosovë kompatibil me ato të vendeve nënshkruese të Deklaratës së Bolonjës. Ky sistem ofron 3 vjet të studimeve të rregullta për diplomë, 2 vjet të studimeve për master dhe 3 vjet të studimeve të doktoratës.

Arsimi i lartë në Kosovë përbëhet nga:

1. Universiteti i Prishtinës me mbi 32,000 studentë në vitin akademik 2006/2007 (ose rreth 67% të numrit të përgjithshëm të studentëve në arsimin e lartë në Kosovë).
2. Universiteti i Mitrovicës ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe. Vlerësohet se numri i studentëve atje lëvizë ndërmjet 4,000 e 6,000 studentë në vitin akademik 2006/2007 (rreth 11% të të gjithë studentëve në arsimin e lartë).
3. Ekzistojnë edhe 19 ofrues private të arsimit të lartë me gjithsej 10,191 studentë në vitin 2006/2007 (ose 22% të të gjithë studentëve në arsimin e lartë). Të gjitha institucionet private, me përjashtim të Universitetit Amerikan të Kosovës, veprojnë në përputhje me procesin e Bolonjës.

ÇËSHTJET KRYESORE

Me futjen graduale në zbatim të programeve të studimeve në harmoni me Bolonjën, të diplomuarit e rinj ballafaqohen me sfidën e punësueshmërisë në tregun vendor të punës për shkak të kohëzgjatjes më të shkurtër të studimeve dhe për shkak të mungesës së informimit e të vetëdijes në mesin e punëdhënësve për kompetencat që fitohen nëpërmjet sistemit të ri. Në anën tjetër, të diplomuarit e mëparshëm që kanë mbaruar studimet e rregullta (ISCED 5) sipas programeve të para-Bolonjës hasin në vështirësi kur duan të vazhdojnë në studimet pasdiplomike për shkak të kërkesave të reja për pranim në këto studime.

Rrjedhimisht, si çështje kryesore të kësaj politike na dalin:

- Transferimi⁶ nga studimet e vjetra në të reja;
- Bërja e dallimit ndërmjet diplomave/thirrjeve të vjetra prej atyre të rejave dhe çështja e punësimit;⁷
- Punësueshmëria pas ciklit të parë të Bolonjës.

QËLLIMET E POLITIKËS

Janë identifikuar këto qëllime politike:

- Të inkurajohet mësimi tërëjetësor duke lehtësuar vazhdimin e studimeve të të diplomuarve sipas programeve të para-Bolonjës në ciklin e njëjtë ose më të lartë të Bolonjës;
- Të ndihmohen punëdhënësit të vlerësojnë kualifikimet e fituara në periudhën para Bolonjës duke i krahasuar ato me periudhën e Bolonjës
- Të ngritet vetëdija në mesin e punëdhënësve për punësueshmërinë e të diplomuarve nga cikli i parë i studimeve sipas Bolonjës.

⁶ Me transfer nënkuptohet e drejta e kandidatit për të vazhduar studimet e veta në ciklin e njëjtë apo në një cikël më të lartë varësisht nga rezultatet e njohura nga studimet paraprake

⁷ Punësueshmëria paraqet një brengë për tërë qeverinë

OPSIONET DHE IMPLIKIMET POLITIKE

Për arritjen e qëllimeve të kësaj politike, jnë marrë para sysh këto opsione:

- 1) Inkurajohet vlerësimi fleksibil dhe i drejtë i arritjeve të studentëve/të diplomuarve të para-Bolonjës;

Alternativë e kësaj është qasja rregullative e barazimit të thirrjeve të vjetra me të rejat që do të përcaktonte mekanizma dhe rregulla rigjide për njohjen e diplomave të fituara nga programet e para-Bolonjës.

Qasja fleksibile dhe e drejtë e të diplomuarve të kohës së para-Bolonjës ka përparësi të shumta ndaj qasjes rregullative. Kjo qasje e rritë transparencën dhe inkurajon mësimin tërëjetësor të të diplomuarve të para-Bolonjës duke nënkuptuar punësueshmëri më të madhe, mundësi më të mëdha për zhvillim personal dhe për plotësimin e nevojave të shoqërisë.

- 2) Ndërtohet një sistem i informimit/bazë e të dhënave për programet e para-Bolonjës dhe të Bolonjës.

Një sistem efektiv i informimit/baza e të dhënave për programet e para-Bolonjës dhe për ato të Bolonjës do të ndihmonte në krijimin e rrethanave të transparencës, informimit të publikut dhe të krahasueshmërisë më të mirë të programeve studimore dhe të thirrjeve akademike. Ky sistem do të përfaqësonte një referencë për punëdhënësit dhe për të gjithë ata që do të vlerësojnë diplomat e studimet e fituara për çfarëdo qëllimi tjetër. Pos kësaj, do të merren në shqyrtim edhe forma të llojllojshme për shpërndarjen e informatave në mesin e punëdhënësve me qëllim të përmirësimit të të kuptuarit të drejtë të programeve të reja sipas Bolonjës.

- 3) Avansohen dhe zbatohen rregulloret për shtojcën e diplomës

Përmbajtja e shtojcës së diplomës është e përkrahur në Udhëzimin Administrativ të MASHT nr. 02/2005, i cili nuk është zbatuar deri më sot. Në anën tjetër, zbatimi i shtojcës së diplomës në shkallë kombëtare është bërë tashmë një rrjedhë e zakonshme në mbarë Evropën dhe është në përputhje të plotë me Konventën e Këshillit të Evropës / UNESCO-s për njohjen e kualifikimeve.

MASAT

Masat në vijim do të ndërmerren për të realizuar qëllimet e kësaj politike:

Qëllimi 1. Inkurajohet vlerësimi fleksibil dhe i drejtë i arritjeve të studentëve / të diplomuarve të para-Bolonjës

Masa 1.1. Obligohen IAL-të të zhvillojnë rregullore të brendshme për këtë çështje

IAL-të do të duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë dhe objektive kredencialet e secilit person. Procedurat duhet të përfundohen në kohë të duhur dhe pa vonesa të shumta që do të dëmtonin kandidatët. Vazhdimi i studimeve sipas Bolonjës është e drejtë e

patjetërsueshme e secilit person dhe puna e tyre nuk do të duhej të hidhet mënjanë, por do të duhet të vlerësohet në mënyrë objektive. Ministria do të nxjerrë një Udhëzim Administrativ ku do të parashtrohen parimet themelore të vlerësimit në partneritet me palët e tjera të involvuara.

Bartësi: MASHT

Afati: Udhëzimi Administrativ do të nxjerret tre muaj pas miratimit të kësaj politike

Qëllimi 2. Sistemi i informimit/baza e të dhënave për programet e para-Bolonjës dhe të Bolonjës

Masa 2.1. Ndërtohet një bazë e të dhënave për programet e para-Bolonjës dhe për ata të Bolonjës

Baza e të dhënave duhet të përmbajë përshkrime të përgjithësuara të programeve studimore të periudhës së para-Bolonjës (listën e kurseve me orët e kontaktit, kërkesat kryesore, e të tjera), ndërsa universitetet janë të obliguara t'i publikojnë të dhënat për programet e reja sipas Bolonjës në web-faqet e veta, përfshirë kurrikulat dhe silabuset e tyre. Kjo përbën një përgjegjësi publike të IAL-ve dhe do të rregullohet me një udhëzim administrativ të hartuar në bashkëpunim me IAL-të dhe palët relevante të involvuara.

Bartës: MASHT

Afati: Baza e të dhënave do të përfundohet deri në qershor 2008.

Masa 2.2. Mblidhen të dhënat themelore nga IAL-të dhe bëhet përditësimi i rregullt i bazës së të dhënave

MASHT do të disenjojë një format të përbashkët dhe do të hartojë udhëzimet përkatëse për IAL-të për të lehtësuar mbledhjen dhe krahasimin e të dhënave të programeve të para-Bolonjës dhe të Bolonjës. Do të caktohet një afat për dorëzimin e të dhënave të para, ndërsa fillimi i secilit vit akademik do të jetë koha e fundit për përditësimin e të dhënave.

Bartësi: MASHT

Afati: Detyrë e vazhdueshme

Masa 2.3. Shpërndahen informata në mesin e punëdhënësve në sketorin privat dhe publik lidhur me strukturën e kualifikimeve dhe për Procesin e Bolonjës

MASHT do të angazhohet në forma të ndryshme të shpërndarjes së informatave në mesin e punëdhënësve lidhur me strukturat kualifikuese dhe me Procesin e Bolonjës, duke përfshirë publikimet, qasjen në bazat e të dhënave, ngjarje për shpërndarje të informatave, e të tjera. MASHT do të inkurajojë IAL-të për një qasje më aktive ndaj punëdhënësve me qëllim të shpërndarjes së informatave dhe të mbledhjes së informatave kthyesë nga ata.

Bartësi: MASHT

Afati: Detyrë e vazhdueshme

Qëllimi 3. Rishikimi dhe zbatimi e rregullores për shtojcën e diplomës

Masa 3.1. Rishikimi i udhëzimit administrativ për shtojcën e diplomës

Ligji për Arsimin e Lartë parasheh përgjegjësinë e MASHT për të autorizuar formën dhe përmbajtjen e shtojcës së diplomës. Kjo punë duhet të mbështetet në Rekomandimet e ENIC/NARIC-ut dhe në praktikat e mira dhe të zyrtarizohet në formë të një udhëzimi administrativ. Ky udhëzim administrativ duhet të vendosë një afat real brenda të cilit institucionet e arsimit të lartë do të fillojnë të lëshojnë shtojca të diplomave.

Bartësi: MASHT

Afati: Udhëzimi administrativ do të nxjerret tre muaj pas miratimit të kësaj politike

Masa 3.2. Institucionet e arsimit të lartë ndihmohen në nxjerrjen e shtojcave të diplomave

Nga institucionet e arsimit të lartë do të kërkohet që të hartojnë e të dorëzojnë plane për nxjerrjen e shtojcave të diplomave. Ato do të inkurajohen që të ndërtojnë sisteme për menaxhimin e informatave të cilat e lehtësojnë nxjerrjen e këtyre dokumenteve. Edhe MASHT do të shpërndajë informata në këtë fushë dhe do të ndihmojë në shkëmbimin e përvojave me vendet e tjera lidhur me këtë çështje.

Bartësi: MASHT

Afati: Planet për nxjerrjen e shtojcës së diplomës duhet të dorëzohen tre muaj pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ.

VLERËSIMI

Vlerësimi do të përqendrohet në rezultatet e matshme të kësaj politike. Vlerësimi do të kontrollojë efektin e masave të politikës krahasuar me këta indikatorë:

- Një sistem funksional i informimit për programet studimore të para-Bolonjës dhe të Bolonjës
- Shumica e IAL-ve kanë zhvilluar sisteme efikase për vlerësimin e arritjeve të të diplomuarve të periudhës së para Bolonjës
- Udhëzimi administrativ për shtojcën e diplomës është në harmoni me avansimet e ENIC/NARIC-ut
- Shtojca e diplomës nxjerret në shumicën e IAL-ve në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ

Një vlerësim nga ekspertë të pavarur do të kryhet, një vit pas miratimit të kësaj politike, me qëllim të përcaktimit të masës së zbatimit të saj. Raporti i vlerësimit do të përdoret për të avansuar/përditësuar këtë dokument. Do të kryhen edhe vlerësime të tjera çdo dy vjet për të ndihmuar në sjelljen e vendimeve.